

EGLANTINA SHTYLLA

**DUKURI TË KATEGOREMËS SEMANTIKE TEK EMRAT E
VEPRIMIT TË GJINISË ASNJANËSE TE FJALORI I GJUHËS
SHQIPE, 1954**

Emrat përbëjnë pjesën dërrmuese e më rëndësishme në gjuhë. Ndaj dhe vendi i tyre në veprat leksikografike do të jetë po kaq me peshë. Brenda klasës së emrave dallohen shumë nënklasa e grupe e nëngrupe paradigmatiske, që organizohen sipas kategorialiteteve e tipologjive të ndryshme kuptimore, strukturore, funksionale etj. Një nga këto nënklasa është dhe ajo e *emrave të veprimit*, e cila vjen gjithmonë duke u shtuar, duke qenë se është e lidhur semantikisht dhe strukturalisht drejtpërdrejt me foljet përgjegjëse apo prej të cilave janë formuar e formohen.

Shqipja njih dy mënyra fjalëformimi dhe ka disa mjete fjalëformuese për të krijuar emra veprimi për këtë kategori fjalësh:

a. Formimi i emrave me ndajshitesa (prapashtesim) që përfshihet te prejardhja dhe që sot është shumë prodhimtar.

b. Formimi pa ndajshitesa ose me konversion përmes shndërrimit të mbiemrave prej pjesorë në emra ose përmes veprimit të ligjit të analogjisë. Procesi i ndërrimit të kategorisë leksiko-gramatikore të mbiemrave prej pjesorë nënkupton një proces disa shkallësh: folje – pjesore e foljes – mbiemërzim i pjesores – emërzim i mbiemrit (formimi i emrave të veprimit): *p.sh., ha - ngrënë – i ngrënë – të ngrënë*. Shumë formime të tilla janë edhe si formime analogjike, si *të notuarit* (nuk kemi mbiemrin *i notuar*), *të ecurit* (nuk kemi mbiemrin *i ecur*) etj.

Klasa e emrave të veprimit të gjinisë asnjane në ditët e sotme, edhe pse është e gjallë në ligjërimet e folura, po vjen duke e ulur ndjeshëm numrin e njësive, sepse në përdorim sidomos në gjuhën e shkruar, po fitojnë përparësi emrat me prejardhje me prapashtesa. Ky proces është i shtrirë në kohë. Për këtë prof. E. Hysa pohon se “një kategori e gjerë emrash të veprimit formoheshin në gjuhën shqipe përgjithësisht nëpërmjet paranyjzimit të pjesoreve të foljeve përkatëse. Kjo përbënte një nga rrugët kryesore deri në Rilindje, krahas formimeve me ndajshitesa, për pasurimin e kësaj kategorie semantike. Emrat e formuar në këtë mënyrë nga pikëpamja gramatikore përfshiheshin në gjininë asnjane, e cila në atë periudhë të zhvillimit të shqipes vërtet filloi të lëkundej, por përsëri ishte ende e gjallë e vepruese. Zhvillimi i mëtejshëm i gjuhës në periudhën e Rilindjes, gjatë periudhës së Pavarësisë dhe sidomos në vitet e pasluftës, kaloi procese të ndryshimeve jo të vogla. Në fillimet e Rilindjes Kombëtare u hodhën bazat e gjuhës letrare

kombëtare, e cila po konsolidohet gjithnjë e më shumë në ditët tona. Në kuadrin e këtyre zhvillimeve na intereson të theksojmë procesin e ç'integritimit të gjinisë asnjane në përgjithësi dhe atë të emrave prejfoljor asnjane në veçanti. Gjinia asnjane në emrat prejfoljorë ka ardhur duke e humbur gjithnjë e më shumë gjallërinë e dikurshme dhe duke u zëvendësuar me emra prejfoljorë të formuar kryesisht me anë të prapashtesave *-im* dhe *-je* e në ndonjë rast dhe me prapashtesën *-esë*.¹

Në shqipe emrat abstraktë që emërtojnë veprime ose gjendje të formuara me ndajshesa, krijojnë disa grupe paradigmatiche (grupe që organizohen nga prapashtesat *-im*, *-je*, *-esë*, *atë*, *-imë*, *-më*). Por duhet të ripohojmë se jo të gjitha këto grupe kanë të njëjtën aftësi, mundësi dhe shkallë prodhimtare. Kjo varet nga faktorë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë, Fjala vjen, shtimi i jashtëzakonshëm i formimeve të emrave me *-im* dhe *-je* në shqipe ndodh edhe spontanisht, por edhe si një fjalëformim i drejtuar (duke bërë formime me vetëdije e duke zvogëluar deri në skajshmëri formimet e tjera për emrat e veprimit).

Formimi i emrave të veprimit është trajtuar, krahas E. Hysës edhe nga studiues ndryshëm, si Sh. Demiraj, L. Buxheli, M. Çeliku etj. Madje studimet kanë përfshirë edhe pasqyrimin e tyre në fjalorët shpjegues të shqipes. V. Memisha ka bërë një studim statistikor për *foljet, emrat e veprimit dhe mbiemrat prejpjesorë* në fjalorët shpjegues kombëtarë. Ai shkruan se “në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 1954, kemi 3480 folje, por *grupi i emrave të veprimit* del me 1153 njësi, 2327 më pak sesa folje (33,1 %). Po sipas këtij studiuesi “në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, 1980, grupi paradigmatic i foljeve, tashmë tërësisht *normativ*, në këtë vepër del me 4183 njësi (703 njësi më shumë se i grupi i FGjSh-së, 1954), është shumë më i plotë, më sistemor, më informues. Grupi i emrave përfshin 2511 leksema (1632 më pak se folje ose 60% të tyre) ose 1358 më shumë se ai të FGjSh-ja. Ai i mbiemrave përfshin 1325 leksema (2858 më pak sesa folje ose 31.7% të tyre) ose 886 më shumë se ai i FGjSh-së. E rëndësishme është se në këtë fjalor dallohet qartë prirja e zhvillimit të këtyre grupeve paradigmatiche brenda sistemit të gjuhës standarde dhe ajo e mbushjes së zbrazëtive në vargje, duke iu afruar simetrisë (jo asaj potenciale, të kërkuar, por asaj reale, të natyrshme e të domosdoshme). Kjo jo vetëm ka sistemuar korpusin e fjalësit, por ka lehtësuar rritjen e pasurimin e kompetencës leksikore e semantike të shqipfolësve dhe të atyre që e mësojnë shqipen si gjuhë të huaj.”²

¹ E. Hysa, *Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare*, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, Tiranë, 1988, f. 300.

² V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 145 – 146.

Ne në punimin tonë të shkurtër po ndalemi te disa dukuri të kategoremës semantike tek emrat e veprimit të gjinisë asnjësore te *Fjalori i gjuhës shqipe*, 1954. Ky fjalor, i hartuar nga Kostaq Cipo (kryetar), Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni, Osman Myderrizi, botim i Institutit të Shkencave është i pari *fjalor shpjegues i mirëfilltë* i shqipes dhe i pari fjalor në fushën e fjalorëve shpjegues kombëtarë. Sipas prof. J. Thomai “Në këtë fjalor jo vetëm u bë një kodifikim kritik i lëndës leksikore e frazeologjike që kishte dalë në fjalorët e mëparshëm, por u sollën edhe shumë materiale të reja. Në të bëhen përpjekjet e para për të zgjidhur edhe çështje të stilistikës në leksikografinë shqipe. Ai shënoi shkallën më të lartë që kishte arritur leksikografia shqipe dhe hapi një etapë të re në leksikografinë tonë, etapën e fjalorëve shpjegues kombëtarë e normativë. “*Fjalori i gjuhës shqipe*” është *i tipit të vogël*, sepse pasqyron shtresën aktive të leksikut të shqipes dhe një pjesë të kufizuar të shtresës pasive, që është krejt e domosdoshme për të kuptuar *gjuhën e sotme shqipe*. Fjalori ka rreth 25000 fjalë, me shpjegime dhe me thënie. Për tipin e ri, për vlerën e zgjidhjeve dhe për fondin e fjalëve e të frazeologjisë që përfshin, ky fjalor pati jehonë të merituar në kritikën shkencore brenda dhe jashtë vendit.”³

Fjalori u mirëprit nga përdoruesi, i specializuar dhe i zakonshëm, dhe sepse mbartte vlera të mëdha dhe pati peshë e rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe dhe, sidomos, për kodifikimin saj. Sipas studiueses Ledi Shamku, “Ky fjalor paraqitet me një vlerë të pamatë në lëmë të studimit sinkronik të shqipes. Duke vendosur t’i binden pasqyrimin besnik të stadiit gjuhësor dhe jo përzgjedhjes së tyre subjektive hartuesit e Fjalorit, përpos të tjerash, lanë si trashëgimi edhe një prerje sinkronike të shqipes së deriatëhershme, madje mund të thuhet se ky pasqyrim ka mbërritur sot krejt i qartë, thuajse në trajtën e një arkivi fotografik të kësaj pasurie të çmuar.”⁴

Është pranuar shkencërisht se fjalori është hartuar i mbështetur në toskërishten letrare, por ai përfshiu fjalë nga të gjitha anët e Shqipërisë, fjalë e shprehje më të përdorshme, të përbashkëta për gjithë folësit e shqipes, duke e zgjeruar fondin e vet me fjalë e shprehje nga të dy dialektet, për të treguar kështu edhe forcën e madhe të gjuhës sonë, - shkruan për të akademik J. Thomai. Sipas tij, mbështetur edhe në parathënien e fjalorit, “Si burim për fjalorin shërbyen fjalorët e botuar, materialet leksikore të arkivit të Seksionit të gjuhësisë e të letërsisë në Institutin e Shkencave, burimet popullore, veprat e rilindësve tanë, tekstet shkencore, shtypi etj., pra, si gjuha e shkruar, ashtu

³ J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 330.

⁴ L. Shamku, *Përse Fjalorin e 54-ës*, në “*Parathënie e botimit anastatik të Fjalorit të Gjuhës shqipe, 1954*”, Tiranë, 2005 / 2010, f. V.

edhe ajo e folur. Nga fjalët krahinore u morën ato që kishin një përhapje më të gjerë, si edhe ato që ishin të vlefshme për leksikun e përgjithshëm. Fjalët ndërkombëtare, si fjalët e huaja në përgjithësi, përfshirë këtu fjalët me burim nga turqishtja, që dalin në letërsinë e shkruar, në folklor ose përdoren dendur në të folur, u shtinë në fjalor. Një vend të gjerë, më shumë se në çdo fjalor të mëparshëm, zë frazeologjia, që është zgjedhur e është shpjeguar me kujdes.”⁵

Klasa e emrave prejfoljorë të gjinisë asnjane nuk kanë zënë vendin që u takonte në këtë vepër kolektive. Kritika shkencore ka vënë re se tipi i fjalorit, kushtet në të cilat u hartua e qëllimet për të cilat u hartua, i sollën disa kufizime vëllimit të tij. Siç thuhet në parathënie, synimi ishte që të hartohet “një fjalor praktik e i përdorshëm, që të pasqyroste gjendjen e sotme... e të udhëzonte për përdorimin e fjalëve e të trajtave të tyre. Puna paraqiste vështirësi të veçantë, se duhej hapur një rrugë e re, pa pritur që të kryhen punime të gjera përgatitore, si ngritja e kartotekës leksikologjike etj.”. Për të mos rritur shumë vëllimin e fjalorit, u lanë jashtë disa klasa fjalësh të prejardhura, si emrat foljorë asnjane (*të afruarit, të ardhurit, të caktuarit...*), shumë emra foljorë të veprimit me prapashtesat *-im /-je* (*derdhje, dramatizim, dyshim, kapje, mbështetje, mënjanim...*), mbiemrat nga pjesoret (*i djezur, i pastruar, i përkëdhelur...*), emrat e popujve a të banorëve të një vendi (*anglezët, gjermanët, mirditasit, rusët, shqiptarët, vlonjatët...*).⁶

1. Në Fjalor gjend shumë rrallë, për të mos thënë tek-tuk, emra asnjane të formuar me konversion ose me analogji. P.sh., *të qeshurit*: veprimi që bëjmë kur qeshim, gazi: ja dhashë të qeshurit. Megjithatë, në fjalor emrat abstraktë të veprimit në gjininë asnjane gjenden gjithandej, edhe pse përparësi u është dhënë formimeve prapashtesore. Fjalori shpjegimin e emrave të veprimit me *-im* dhe *me-je* gati e ka bërë në sistem sinonimi me një emër asnjane ose me perifrazim ku ky lloj emri është gati kurdoherë i pranishëm.

2. Shumë fjalë shpjegohen me emra veprimi abstrakt asnjane, por këta emra asnjane nuk gjenden në fjalor. Mendojmë se ata duhet të ishin domosdoshmërisht të pranishëm, sepse fjalori duhet të shpjegojë vetveten. Po japim disa shembuj ilustrues (në një kohë kur i gjithë fjalori është ndërtuar në mënyrë të tillë).

Afishim: të ngjiturit e një afisheje në një vend. (të ngjiturit nuk është pasqyruar në vepër).

Afrim: të ardhurit më afër; **-i i afatit**; të shëmbëlltyerit; të përngjarët. (*të shëmbëlltyerit* dhe *të përngjarët* nuk janë pasqyruar në vepër).

⁵ J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 331.

⁶ J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 331.

Derdhje: të derdhurit përgjithësisht; të derdhurit e pareve në një bankë, në një arkë kursimi) (*të derdhurit* nuk është pasqyruar në vepër).

Përkthim: të përkthyerit nga një gjuhë në tjetrën (*të përkthyerit* nuk është pasqyruar në vepër)

Përmbytje: 1. të mbyturit e botës n'ujë, sipas legjendës biblike; 2. Vërsdim i madh ujrash. (*të mbyturit* nuk është pasqyruar në vepër)

Thjeshtim: të thjeshtuarit e një pune(*të thjeshtuarit* nuk është pasqyruar në vepër).

3. Shumë emra veprimi të formuar me prapashtesat *-im* ose *-je* jepen të barasvlershëm dhe të shpjeguar me emrat gjegjës asnjans, por emrat asnjans nuk gjenden në fjalor. P.sh.:

Ardhje: t' ardhurit; Përbushje: të përbushurit; Përmbysje: të përmbysurit; Thithje: të thithurit; Thumbim: të thumbuarit; Thyerje: të thyerit etj.

4. Emrat e veprimit të gjinisë asnjansë shërbejnë për të shpjeguar ndonjë njësi me të cilën ka lidhje prejardhjeje, por vetë emri nuk gjendet në fjalor, edhe pse në rrafshin sinkronik sot ka denduri shumë të madhe përdorimi:

Folme (e): 1. mënyra e të folurit të një njeriu, fjalët e thëna prej ndonjërit; të folët e një fshati, të një qyteti; 2. Premtim.

5. Nganjëherë emrat e veprimit mungojnë fare, qoftë në formën e një emri me formim prapashtesor, qoftë si emër prejfoljor asnjans. P.sh., në fjalor kemi foljen *laj*, por nuk është pasqyruar as emri *larje* as emri *të larët*; është folja *Thinj*, por jo emri *thinje* apo *të thinjurit*.

6. Në qoftë se dukuritë e mësipërme lidhen me makrostrukturën e Fjalorit, duhet të theksojmë se problemet që mbartin ato, reflektohen edhe te mikrostruktura. Nëse fjalori ka merita për zbërthimin kuptimor dhe për shpjegimin e kuptimeve të fjalëve, në varësi nga tipi i tij, vëllimi, koha e hartimit, përgatitjes dhe aftësive të hartuesve, nga tradita leksikografike shqipe njëgjuhëshe etj., për emrat prejfoljorë asnjans ka shumë zbrazëti. Derisa mungojnë shumica e vetë emrave nuk mund të kërkojmë te ata që pasqyrohen shpjegime të plota kuptimore, dukuritë e sinonimisë, antonimisë, polisemisë, shembuj ilustrues si modele të ndërtimeve sintaksore, elemente të stilistikës gjuhësore etj.

Si përfundim, edhe pse autorët e fjalorit kanë bërë një punë të madhe, të vështirë të parratur më parë, fjalori do të kishte më shumë vlera nëse do të kishte më shumë vend edhe klasa e emrave asnjans të tipit *të jetuarit*, *të menduarit*, *të qeshurit* etj. Këtë çështje e ka zgjidhur deri diku Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, nga i cili kemi shkëputur pasqyrimin tyre si zëra të veçantë.

JETUAR.~IT (të) as. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve JETOJ, JETOHET. *Të jetuarit e një ngjarjeje. Të jetuarit afër popullit (afër shokëve). Të jetuarit me të kaluarën. Të jetuarit gjatë (pak, shumë). Të jetuarit mirë. Mënyra e të jetuarit.*

MENDÚAR,~IT (të) *as.* 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve MENDOJ, MENDOHEM. 2. *psikol.* Formë e pasqyrimit të përgjithësuar të botës objektive në vetëdijen e njeriut me anë të nocioneve, të gjykimeve dhe të arsytimeve; veprimtaria mendore për të zbuluar ngjashmëritë e dallimet që kanë sendet e dukuritë e ndryshme si edhe lidhjet e varësitë ndërmjet tyre; shkallë e veçantë, më e larta, në procesin e njohjes e të pasqyrimit të botës reale në ndërgjegjen e njeriut; mënyra se si mendon dikush; mendim. *Të menduarit krijues (logjik, abstrakt, kritik). Të menduarit me figura. Llojet e të menduarit. Zhvillimi i të menduarit. Veprimtaria e të menduarit. Shpejtësia e të menduarit. Mënyra e të menduarit. Truri është organi i të menduarit.*

QESHUR,~IT (të) *as.* 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve QESH, QESHEM. *Të qeshurit me zë (pa zë). Të qeshur me pahir (me zor). Ia dha (ia krisi, ia shkrep) të qeshurit.* 2. Shaka; tallje. *E tha me të qeshur. E mori me të qeshur. E nisën me të qeshur. Nuk e kam me të qeshur.* • **Me të qeshur e me të ngjeshur** duke e paraqitur diçka si me shaka, por në të vërtetë duke e qortuar e sharë dikë ose duke i bërë një të keqe.